

Rapporti *Vjetor* 2025

- Kontakt Tel: +355 (0) 4 22 70 576
- Email: info@intersig.al
- Website: www.intersig.al

Intersig Vig

Make Life Easy!



Përmbajtja

- | | |
|---|---|
| 01. Struktura e Intersig VIG | 10. Intersig në Tregun Shqiptar |
| 02. Organizimi i Intersig VIG | 11. Tregues për Vitin 2025 |
| 03. Historiku i Intersig VIG | 12. Menaxhimi i Riskut |
| 04. Vienna Insurance Group (VIG) | 13. Raporti i Auditit të Brendshëm |
| 05. Programe Risigurimi | 14. Opinioni i Shoqërisë Audituese |
| 06. Intersig në Shqipëri | 15. Pasqyrat Financiare |
| 07. Vizioni dhe Misioni | 16. Objektivat 2026 |
| 08. Stafi i Intersig | 17. Kontakt |
| 09. Tregu i Sigurimeve 2025 | |

Struktura e Intersig VIG

Intersig Vienna Insurance Group operon në tregun shqiptar prej Tetorit 2001 në fushën e sigurimit të jo-jetës.

Struktura e Aksionarëve

89,98%

Vienna Insurance Group

10,02%

Z. Gentian Sula

Këshilli Mbikëqyrës

Z. Christoph Rath — Kryetar
Z. Peter Hoefinger — Anëtare
Znj. Liane Hirner — Anëtare


Bordi Drejtues

Znj. Fitnete Sulaj — Drejtore e
Përgjithshme, Anëtar Bordi
Z. Fatmir Bërdica — Anëtar Bordi
Z. Justin Gjini — Anëtar Bordi

Shoqëri nën Zotërim

Intersig VIG zotëron 50% të VIG Services Albania Shpk.

Organizimi i Intersig VIG



* Intersig VIG merr shërbime back-office nga VIG Services Shqipëri: Financë & Kontabilitet, IT dhe Trajtim Dëmesh.

** Shërbime të ndara mes Intersig VIG dhe Sigma InterAlbanian, të dyja pjesë e Vienna Insurance Group.

Historiku i Intersig VIG



INTERSIG
VIENNA INSURANCE GROUP

2001

Intersig u themelua në vitin 2001 nga një grup aksionarësh vendas, të cilët morën licencën për një kompani jo-jete në Republikën e Shqipërisë.

2001 – 2011

Intersig pati një rritje të qëndrueshme në treg. Vienna Insurance Group bleu shumicën e aksioneve të Intersig Sha., sipas një marrëveshjeje të firmosur më 25 Gusht 2011 në Tiranë.

2011 – Sot

Aktualisht VIG zotëron 89,98% të aksioneve të Intersig VIG, fakt që ka influencuar në përmirësimin e produkteve dhe shërbimeve. Shoqëria ka reformuar shumë procese duke investuar në cilësinë e stafit dhe digjitalizimin e procedurave të shitjes së produkteve të sigurimit.

Vienna Insurance Group

Vienna Insurance Group, me seli të regjistruar në Vjenë, është një nga grupet më të mëdha ndërkombëtare të sigurimeve në Evropën Qendrore dhe Lindore, me mbi 25,000 punonjës në rreth 50 shoqëri të shpërndara në 30 shtete.

Në Shqipëri, Grupi VIG përfaqësohet nga tre kompani sigurimi: dy kompani të sigurimeve jo-jetë dhe një kompani e sigurimeve të jetës.



A+

Vlerësim nga Standard & Poor's, me perspektivë të qëndrueshme

Listimet: VIG është e listuar në Bursën e Vjenës që nga viti 1994, në Bursën e Pragës nga 2008 dhe në Bursën e Budapestit nga nëntori 2022. VIG Re, me qendër në Pragë, është shoqëria e risigurimit e grupit, gjithashtu e vlerësuar me “A+” nga S&P që nga themelimi i saj në 2008.

Programe Risigurimi me Standarde

A+

Nëpërmjet nënshkrimit të Marrëveshjeve të Risigurimit për produktet e sigurimit jo-jetë, Shoqëria INTERSIG VIG ofron për klientët e saj, në përputhje me Licencën e Ushtrimit të Aktivitetit, garanci të plotë për çdo risk.

Marrëveshjet e Risigurimit i mundësojnë shoqërisë transferimin e rrezikut në shoqëritë e mëdha të Risigurimit. Ato mundësohen nga VIG RE si dhe nga risigurues të tjerë, të gjithë të vlerësuar me “A+” nga Standard & Poor's.

VIG Group vlerësohet me “A+” me perspektivë të qëndrueshme nga Standard & Poor's, gjë që e bën Vienna Insurance Group shoqërinë më të vlerësuar në indeksin kryesor ATX të Bursës së Vjenës.

VIG Re, me qendër në Pragë, është shoqëria e risigurimit e grupit VIG, e cila mbështet të gjitha shoqëritë e grupit dhe më tej. Ajo ka një vlerësim “A+” me perspektivë të qëndrueshme nga Standard & Poor's që nga themelimi i saj në vitin 2008.

Përfshirja në marrëveshje risigurimi i mundëson shoqërisë INTERSIG VIG kapacitete më të larta të marrjes në sigurim, si dhe ekspertizë të dedikuar për risqe të veçanta, duke bërë të mundur lëshimin e policave me limite nga më të lartat në treg, për të gjitha linjat e biznesit jo-jetë.

Vizioni dhe Misioni

Vizioni

Të jemi ndër kompanitë lider në tregun e sigurimeve dhe shërbimeve financiare në Shqipëri dhe rajon, duke ndërtuar rritje të qëndrueshme dhe duke maksimizuar vlerën për klientët, partnerët dhe aksionarët tanë.

Synojmë të jemi zgjedhja e parë për individët, familjet dhe bizneset, përmes produkteve të besueshme, shërbimit cilësor dhe mbrojtjes financiare të përshtatur. Ne besojmë se siguri nuk është vetëm mbrojtje, por edhe siguri për të ardhmen.

Misioni

Të ofrojmë produkte dhe shërbime siguri me standarde të larta cilësie, duke garantuar besim, transparencë dhe mbështetje të vazhdueshme për klientët tanë. Çdo ditë veprojmë me integritet, përgjegjësi dhe profesionalizëm, duke vendosur klientin në qendër.

Përmes inovacionit dhe fleksibilitetit, synojmë të tejkalojmë pritshmëritë e klientëve dhe të ndërtojmë marrëdhënie afatgjata të bazuara në besim. Përgjegjësia sociale mbetet vlerë thelbësore: mbështesim nisma në ndihmë të personave me aftësi të kufizuara dhe fëmijëve.

Premtimi ynë: *Make Life Easy!*

Premtimi i VIG: *Protecting What Matters!*

Stafi i Intersig VIG

Një kujdes i veçantë i kushtohet trajnimit të vazhdueshëm brenda dhe jashtë vendit të punonjësve tanë, në mënyrë që t'u ofrojmë klientëve në çdo kohë shërbimin e duhur profesional.



Tregu i Sigurimeve në Shqipëri 2025

+10,54%

Rritja e tregut

27,089,756

Prime bruto (mijë lekë)

1,676,640

Kontrata sigurimi


Gjatë vitit 2025, tregu i sigurimeve në Republikën e Shqipërisë pësoi një rritje prej 10,54% krahasuar me një vit më parë. Volumi i primeve të shkruara bruto u rrit nga 24,505,779 mijë lekë në 27,089,756 mijë lekë, ndërsa numri i kontratave të lidhura arriti në 1,676,640, me një rritje prej 5,07%.

Tregu mbeti i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 90,99% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, ndërsa sigurimet e Jetës zunë 8,99%. Brenda tregut Jo-Jetë, primet e sigurimit vullnetar zunë 31,44% dhe primet e sigurimit të detyrueshëm 68,56% të totalit.

Gjatë vitit 2025, dëmet e paguara bruto në treg arritën në rreth 8,590,751 mijë lekë, ose 0,75% më pak se në vitin 2024. Ndërkohë, dëmet e paguara bruto në sigurimin motorik për vitin 2025 kapën vlerën 6,536,869 mijë lekë, duke pësuar një rritje prej rreth 4,78% krahasuar me vitin 2024.


Intersig VIG në Tregun Shqiptar

Primet e Shkruara Bruto
Jo-Jetë




Pjesa e Intersig VIG

Dëmet e Paguara
në Numër



Pjesa e Intersig VIG

Dëmet e Paguara
në Vlerë



Pjesa e Intersig VIG

■ Intersig VIG ■ Të tjerë

Gjatë vitit 2025, Intersig VIG ka shkruar rreth 2,272 milionë lekë prime, duke zotëruar kështu 9,22% të tregut të sigurimeve jo-jetë.

Intersig ka paguar rreth 820 milionë lekë dëme gjatë vitit 2025. Numri i kërkesave të dëmeve të paguara nga Intersig gjatë 2025 është 11,141, ose 15,36% e të gjitha kërkesave të tregut.

Tregues për Vitin 2025

Treguesit kryesorë të qëndrueshmërisë financiare të shoqërisë tregojnë një pozicion solid mbi nivelet minimale të kërkuara nga kuadri rregullator.

231,4%

Treguesi i Mjaftueshmërisë së
Kapitalit

162,2%

Treguesi në Mbulimin e
Provigjioneve Teknike

Procesi i Vlerësimit të Riskut

1

Kuantifikimi

Përcaktohet niveli i kapitalit që duhet alokuar për secilin rrezik.

2

Planifikimi

Vendosen kufijtë minimalë dhe maksimalë të ekspozimit; njësitë përgjegjëse përcaktojnë limitet dhe Bordi miraton nivelin e tolerancës.

3

Përcaktimi

Identifikohen rreziqet që mund të pranohen brenda kufijve dhe ato që duhet të shmangen ose transferohen plotësisht.

4

Mitigimi

Hartohen masa dhe metoda për reduktimin ose transferimin e rreziqeve, me qëllim mbajtjen brenda limiteve të pranueshme.

5

Monitorimi

Kryhet monitorim periodik për rreziqet me ndikim të lartë dhe vlerësohet nëse qëndrojnë brenda limiteve të përcaktuara.

6

Marrja e Masave

Në rast se nivelet e rrezikut tejkalojnë kufijtë e lejuar, ndërmerren masa korrigjuese dhe mitigjuese.

Vlerësimi dhe Menaxhimi i Riskut

Intersig kryen në mënyrë të rregullt vjetore procesin e vlerësimit të riskut të shoqërisë. Për këtë qëllim është krijuar struktura e brendshme e menaxhimit të riskut, e përbërë nga Departamenti i Menaxhimit të Riskut, ku përfshihet edhe Komiteti i Menaxhimit të Riskut.

Për kontrollimin dhe vlerësimin e risqeve, Intersig përdor modelet e shoqërisë mëmë, Vienna Insurance Group. Risqet kryesore janë të identifikuara dhe kanë të përcaktuar frekuencën, shkallën e rëndësisë, si dhe masat e kontrollet e ndërmarra për secilin risk.

Risqet Kryesore të Identifikuara

- Risku i tregut
- Risku i marrjes në sigurim jo-jetë
- Risku i marrjes në sigurim shëndeti
- Rreziku i mospagimit të palës
- Risku operacional
- Risku i përputhshmërisë ligjore
- Risku i TI dhe sigurisë
- Risku i likuiditetit
- Risku i reputacionit
- Risku strategjik

Vlerësimi dhe Menaxhimi i Riskut

Prova e Rezistencës

Vlerësimi dhe klasifikimi i risqeve kryhet në bazë skenari dhe ndjeshmërie ndaj ngjarjes. Llogariten nevojat për kapital shtesë në rast se ndodhin skenarët e situatave katastrofike, epidemike dhe të krizave financiare.

Administrimi i Kapitalit dhe Aftësia Pague

Intersig siguron të mbajë një fond garancie jo më pak se 1/3 e marzhit të aftësisë pague minimale, në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.

Plani i Vazhdimësisë së Aktivitetit

Intersig ka hartuar planin e vazhdueshmërisë së aktivitetit, ku parashikohen skenarët e risqeve të mundshme dhe masat që duhet të ndërmerren në çdo rast nga personat përgjegjës.

Profili i Përgjithshëm i Riskut

Intersig ka marrë masat e nevojshme për mbrojtjen nga pasojat e skenarëve të mësipërm dhe, për rrjedhojë, risku i shoqërisë rezulton i menaxhueshëm.

Raporti i Auditit të Brendshëm

Përmbledhje për Vitin 2025 — Njësia e Auditit të Brendshëm

Gjatë vitit 2025, Njësia e Auditit të Brendshëm të shoqërisë INTERSIG VIG ka kryer aktivitetet audituese në përputhje me Planin Vjetor të Auditimit të Brendshëm, të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës. Auditimet janë realizuar në të gjitha fushat kryesore të veprimtarisë, duke mbuluar aspektet operacionale, financiare, të performancës dhe të pajtueshmërisë.

Rezultatet e auditimeve konfirmojnë se INTERSIG VIG disponon një mjedis të fortë kontrolli të brendshëm dhe praktika efektive të menaxhimit të rrezikut në shumicën e proceseve. Shoqëria operon në përputhje me kërkesat e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF), udhëzimet e Vienna Insurance Group (VIG) dhe rregulloret e brendshme.

Funksionet e kontrollit të brendshëm janë të implementuara në mënyrë efektive dhe kontribuojnë në zbutjen e rreziqeve. Gjatë vitit 2025 nuk janë identifikuar gjetje me nivel rreziku “të lartë” ose “të mesëm”.

Raporti i Auditit të Brendshëm

Shitjet dhe Administrimi i Produkteve të Sigurimit

Auditimet e kryera në fushën e shitjeve evidentuan një performancë të mirë të proceseve të regjistrimit dhe shitjes së produkteve të sigurimit, si nëpërmjet rrjetit të agjentëve dhe zyrave të shoqërisë, ashtu edhe nëpërmjet kanaleve online.

Gjithashtu, janë kryer kontrole mbi arkëtimin e primeve të policave vullnetare, si dhe mbi menaxhimin dhe inventarizimin e policave të sigurimit të detyrueshëm. Është verifikuar saktësia e vlerave të primeve për secilën policë dhe rakordimi i tyre me numrin e policave të përdorura e të shitura, në përputhje me rregulloret e brendshme dhe vlerësimin e rrezikut.

Raporti i Auditit të Brendshëm

Administrimi Financiar dhe Kontabiliteti

Funksionet e Administrimit Financiar kryhen në zyrat qendrore të INTERSIG VIG, ndërsa aktivitetet e Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar realizohen nga VIG Services Shqipëri.

Gjatë vitit 2025, auditimet janë fokusuar në:

- administrimin dhe menaxhimin e policave të sigurimit;
- proceset e trajtimit të policave në sistemin MBA dhe implementimin e tyre në sistemin SAP;
- raportimin e primeve të shkruara dhe të arkëtuara;
- menaxhimin e debitorëve dhe inventarit fizik e kontabël të policave të detyrueshme;
- llogaritjen e komisioneve në përputhje me kërkesat e AMF-së dhe vendimet e brendshme të shoqërisë.

Raporti i Auditit të Brendshëm

Administrimi Financiar • Marrja në Sigurim

Kontrollet e kryera në sistemin SAP konfirmuan saktësinë e regjistrimeve kontabël të primeve të shkruara, primeve të arkëtuara dhe balancave të debitorëve sipas kompanisë, degëve dhe agjentëve. Proceset e rakordimit midis sistemeve MBA dhe SAP rezultuan materialisht të sakta. Menaxhimi i inventarit të policave dhe rakordimi me Byronë Shqiptare të Sigurimit u realizuan në përputhje të plotë me rregulloret.

Marrja në Sigurim dhe Menaxhimi i Rrezikut

Auditimet u fokusuan kryesisht në produktet vullnetare, përfshirë sigurimet e pronës, përgjegjësi dhe garancive. Janë kryer kontrole mbi kriteret e pranimi në sigurim, vlerësimin e rrezikut për secilin produkt, analizën e klientit dhe të pronës së siguruar, si dhe dokumentacionin e proceseve.

Rezultoi se proceset e vlerësimit dhe menaxhimit të rrezikut funksionojnë në mënyrë efektive dhe janë në përputhje me rregulloret e brendshme, kërkesat e tregut, legjislacionin e AMF-së dhe udhëzimet e Grupit VIG.

Raporti i Auditit të Brendshëm

Trajtimi i Dëmeve

Kontrollet në fushën e trajtimit të dëmeve janë kryer bazuar në vlerësimin e rrezikut dhe kanë mbuluar pothuajse të gjitha produktet e licencuara të sigurimit.

Auditimet për dëmet materiale dhe jomateriale të pronës kanë përfshirë të gjithë ciklin e procesit, duke filluar nga verifikimi i mbulimit, regjistrimi i dosjes, inspektimi dhe vlerësimi i dëmit, deri në miratimin dhe pagesën e dëmshpërblimit. Gjithashtu janë kontrolluar:

- respektimi i afateve ligjore për trajtimin e dëmeve;
- kohëzgjatja e procesit të dëmshpërblimit;
- plotësia dhe saktësia e dokumentacionit.

Rezultatet treguan një performancë të kënaqshme dhe një profil rreziku të ulët.

Raporti i Auditit të Brendshëm

Aktivitetet e Risigurimit

Aktivitetet e risigurimit kryhen nga Departamenti i Risigurimeve Shared Services, i cili ofron shërbime për INTERSIG VIG dhe SIGMA VIG. Partneri kryesor i risigurimit është VIG Re, pjesë e Vienna Insurance Group.

Auditimet janë fokusuar në:

- miratimin e limiteve të cedimit të primeve;
- përputhshmërinë me rregulloret e Grupit VIG;
- rinovimin e marrëveshjeve të risigurimit;
- llogaritjen e primeve të ceduara dhe raportimin përkatës.

Ky funksion paraqiti një nivel të ulët rreziku dhe kontrole të brendshme efektive. Për këtë fushë nuk janë lëshuar rekomandime, duke konfirmuar efikasitetin e plotë të proceseve.

Raporti i Auditit të Brendshëm

Shoqëria ka demonstruar një angazhim të vazhdueshëm në drejtim të qeverisjes korporative. Funkcioni i Menaxhimit të Rrezikut operon në përputhje me kërkesat e AMF-së dhe standardet e Grupit VIG. Në fushën e Burimeve Njerëzore, auditimet konfirmuan se proceset e rekrutimit, administrimit të pagave dhe vlerësimit të performancës kryhen në përputhje me kuadrin ligjor dhe procedurat e brendshme.

Aktivitetet e Departamentit Ligjor

Auditimet u fokusuan në mbrojtjen dhe përfaqësimin e shoqërisë në proceset gjyqësore, trajtimin e dosjeve të dëmeve në proces gjyqësor, dhënien e opinioneve juridike, përdorimin e ndërmjetësimit për shmangien e proceseve gjyqësore dhe ndjekjen e procedurave të regresit për rikuperimin e shumave të dëmshpërblimeve.

Auditimet evidentuan nevojën për përmirësim të mëtejshëm të performancës në menaxhimin dhe zgjidhjen e çështjeve që trajtohen në rrugë gjyqësore.

Raporti i Auditit të Brendshëm

Opinionit i Auditit të Brendshëm për Vitin 2025

Gjatë gjithë vitit 2025, Departamenti i Auditit të Brendshëm ka monitoruar në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e rekomandimeve të miratuara dhe ka ndjekur statusin e realizimit të tyre.

Në tërësi, rezultatet e auditimit rikonfirmojnë stabilitetin operacional të INTERSIG VIG dhe aftësinë e saj për të ruajtur mekanizma efektivë kontrolli, të cilët jo vetëm parandalojnë rreziqet, por edhe zbusin në mënyrë efikase pasojat e mundshme.

Bazuar në rezultatet e auditimeve, Njësia e Auditit të Brendshëm shpreh siguri të arsyeshme se aktivitetet e INTERSIG VIG janë zhvilluar në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator që rregullon tregun e sigurimeve në Shqipëri, si dhe me kërkesat dhe standardet e Grupit Vienna Insurance Group.

Gjatë angazhimeve audituese të vitit 2025 nuk janë evidentuar gjetje kritike apo gabime materiale që mund të kenë ndikim domethënës në aktivitetin dhe stabilitetin financiar të shoqërisë.

Opiniononi i Shoqërisë Audituese

Raporti i Audituesit të Pavarur



Grant Thornton Sh.p.k.
Rr. "Sam Frashëri"
Kompleksi T.J.D. Shtëpi B, Floor 1
1001 Tiranë
Albania
T +355 44 525 680
E contact@gt.com

Raporti i Audituesit të Pavarur

Për aksionerët e "Intersig Vienna Insurance Group" sh.a,

Opiniononi

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të "Intersig Vienna Insurance Group" sh.a. (këtu e më poshtë referuar "Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e poziticionit financiar me datën 31 dhjetor 2025, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të anthurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e fluideve të parës për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëdhun paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, poziticionin financiar të Shoqërisë me datën 31 dhjetor 2025, performancën financiare dhe fluksat e parës për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me në përputhje me Ligjin nr. 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" dhe politikat kontabël të detajuara në shënimin shpjegues 2.

Bazat për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës të Kontabilitetit Profesional të njohur nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Etikës për Kontabilitet (IESBA), kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si dhe kemi përmblusur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Çështjet Kryesore të Auditimit

Çështjet kryesore të auditimit janë ato çështje që, sipas gjykitim tonë profesional, kanë qenë më të rëndësishmet gjatë auditimit të pasqyrave financiare për periudhën aktuale. Këto çështje, si dhe reziqet përkatëse të anomaliave materiale, janë trajtuar në kontekstin e auditimit të pasqyrave financiare në tërësi dhe në formimin e opinionit tonë mbi to, dhe ne nuk shprehim një opinion të veçantë mbi këto çështje.

Informacione të tjera

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe publikimin e informacioneve të tjera. Informacione të tjera të marrë në datën e këtij raporti auditimi janë "Aneks shoqërues suplementare", por nuk përfshihen në pasqyrat financiare dhe raportin e auditimit.

Opiniononi ynë për pasqyrat financiare nuk përfshin informacione të tjera dhe ne nuk ofrojmë asnjë siguri mbi to. Si pjesë e auditimit, është përgjegjësia jonë të lexojmë këto informacione të tjera dhe të vlerësojmë nëse, bazuar në informacionet e marra gjatë auditimit tonë, ai përmban ndonjë mospërputhje materiale me pasqyrat financiare ose ndonjë gabim material të dukshëm. Nëse konkludojmë se ekziston një gabim material të faktive në informacione të tjera, duhet ta raportojmë atë fakt. Sikurse është paraqitur në anekset suplementare Shoqëria ka logaritur marzhin mbi aftësinë paguese dhe aktivet në mbulim të rezervave teknike

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare individuale në përputhje me politikat kontabël të përshkruara në Shënimin 2 si edhe për sistemin e kontrollit të brendshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqesë në shënimet shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Shoqërisë, dhe të përdorë parimin e vijimësisë si bazë kontabile, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomali mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe skepticismin tonë profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomaliave materiale në pasqyrat financiare individuale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë, se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.

Ekstrakt — Grant Thornton Sh.p.k., audituesi i pavarur i pasqyrave financiare të vitit 2025 (faqe 1/5)



Opiniononi i Shoqërisë Audituese

Përgjegjësitë dhe Baza për Opinionin

CKA 1: Vlerësimi i Detyrimeve të Kontratave të Sigurimit

Ceshtja Kryesore e Auditimit	Si u Trajtua Ceshtja gjate Auditimit
Detyrimet e kontratave të sigurimit perfaqesojne detyrimin me te madh ne bilancin e gjendjes se Shoqërisë. Vlerësimi i tyre perfishin gjykim te konsiderueshem dhe perdorimin e modeleve aktuariale qe perfishine supozime lidhur me frekuencen dhe ashpersine e ardhshme te demeve, modelet e zhvillimit, inflacionin, tendencat gjyqesore dhe variabla te tjere. Ndryshime te vogla ne keto supozime mund te kene ndikim material ne pasqyrat financiare. Per shkak te kompleksitetit te modeleve te perdorura, subjektivitetit te supozimeve dhe materialitetit te gjendjeve te perfishira, vlerësimi i detyrimeve te kontratave te sigurimit eshte identifikuar si Ceshtje Kyçe Auditimi.	Procedurat tona te auditimit perfishjne, ndermjet te tjerave: • Angazhimin e specialistit tone te pavarur aktuaristik sipas SNA 620 per te vlerësuar metodologjite dhe modelet e perdorura nga drejtimi per vlerësimin e detyrimeve te kontratave te sigurimit. • Testimin e plotësisë dhe saktësisë se te dhenave baze te perdorura ne llogaritjet aktuariale. • Vlerësimin e arsyeshmërisë se supozimeve kryesore duke i krahasuar me eksperiencen historike, benchmarke te industrisë dhe inpute te veshtueshme te tregut. • Vlerësimin e procesit te drejtitimit per vendosjen e supozimeve dhe kuadrin e qeverisjes per ndryshimet e modeleve aktuariale. • Kryerjen e rillogaritjeve te pavarura, ne baze kampioni, te caktimeve te caktuara te rezervave. • Vlerësimin e mjaftueshmërisë se shenimeve lidhur me detyrimet e kontratave te sigurimit ne pasqyrat financiare.
Konkluzioni i auditorit: Bazuar ne procedurat tona dhe punen e aktuarit te pavarur, konsiderojme qe vlerësimi i rezervave teknike te sigurimit eshte i arsyeshem dhe ne perputhje me Ligjin nr. 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" dhe politikat kontabël të detajuara në shënimin shpjegues 2. Nuk identifikuam asnje pasakesi materiale.	

CKA 2: Vlerësimi i Reserves se Primit te Pafitur dhe Reserves per Rrezikun e Paskaduar

Ceshtja Kryesore e Auditimit	Si u Trajtua Ceshtja gjate Auditimit
Rezerva e Primit te Pafitur (RPP), duke perfishire Rezerven per Rrezikun e Paskaduar (URR), eshte detyrimi i dyle me i madh ne bilancin e gjendjes dhe percakton drejtperdrejte shumen e te ardhurave nga primet te njohura ne periudhe. Risqet kryesore lidhen me plotësinë dhe saktësinë e te dhenave baze te polisave, zbatimin e sakte te metodologjise pro-rata per te gjitha linjat e biznesit dhe gjykimin e perfishire ne Testin e Mjaftueshmërisë se Detyrimeve (LAT) dhe percaktimin e URR. E identifikuam kete si Ceshtje Kyçe Auditimi per shkak te mardhënies se drejtperdrejte mes llogaritjes se RPP dhe te ardhurave te raportuara nga primet.	Procedurat tona te auditimit perfishjne, ndermjet te tjerave: • Angazhimin e specialistit aktuaristik te pavarur per te audituar te gjitha llogaritjet RPP dhe URR, duke verifikuar metodologjine Pro Rata Temporis dhe llogaritjet e RPP risigurim sipas llojit te kontrates. • Testimin e plotësisë dhe saktësisë se te dhenave baze te polisave, duke rakorduar gjendjet e primeve dhe rezervave me librin e madh dhe raportimet rregullatore. • Kryerjen e rillogaritjeve te pavarura te RPP-se ne kampion polisash neper linjat materiale te biznesit. • Shqyrtimin e Testit te Mjaftueshmërisë se Detyrimeve (LAT) dhe llogaritjeve te URR, duke konfirmuar mjaftueshmërisë e pergjithshme te rezervave. • Kryerjen e procedurave analitike krahasimore dhe te serive kohore.
Konkluzioni i auditorit: Bazuar ne procedurat tona dhe punen e aktuarit te pavarur, RPP dhe URR jane llogaritur sakte ne perputhje me Ligjin nr. 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" dhe politikat kontabël të detajuara në shënimin shpjegues 2. Nuk identifikuam asnje pasakesi materiale.	

Ekstrakt — Raporti i Audituesit të Pavarur, Grant Thornton Sh.p.k. (faqe 2/5)

Opinion i Shoqërisë Audituese

Çështje Kryesore të Auditimit

CKA 3: Rikuperueshmëria e Aktiveve të Risigurimit

Cështja Kryesore e Auditimit	Si u Trajtua Cështja gjatë Auditimit
Aktivet e risigurimit përfaqësojnë një gjendje të konsiderueshme në bilancin e gjendjes së Shoqërisë, duke përfshirë pjesën e risiguruesve në rezervat e dëmeve dhe në primin e pafitur. Shoqëria mban gjithashtu një detyrim depozite risigurimi ndaj risiguruesit kryesor. Risqet kryesore janë cilësia kreditore e paleve të risigurimit, saktësia e llogaritjeve të cedimit dhe trajtimi i saktë i depozitës së risigurimit. E identifikua këtu si Cështje Kyçe Auditimi për shkak të madhësisë së gjendjes dhe kompleksitetit të strukturave të risigurimit.	Procedurat tona të auditimit përfshijnë, ndërmjet të tjerave: - Vlerësimin e bonitetit të paleve kryesore të risigurimit duke shqyrtuar vlerësimet e disponueshme të krediteve dhe konfirmuar që nuk ekzistonte asnjë evidence objektive e zhvlerësimit sipas SNK 39. - Testimin e zbatimit të normave kontraktuale të cedimit në baze kampioni, duke konfirmuar konsistencën me vlerësimet bruto të rezervave të audituara nën CKA 1. - Shqyrtimin e termave dhe trajtimit kontabel të depozitës së risigurimit, përfshirë ngarkesën e interesit dhe mekanizmin e kompensimit të dëmeve. - Kryerjen e testimit të periudhës së prerjes për primet e ceduara dhe rakordinin e të ardhurave nga komisionet e risigurimit me deklaratat e marrëveshjes dhe konfirmimet e paleve. Konkluzion i auditorit: Bazuar në procedurat e kryera, aktivet e risigurimit janë matur në mënyrë të përshtatshme, nuk u identifikuan tregues zhvlerësimi sipas SNK 39. Nuk identifikua asnjë pasaktësi materiale.

CKA 4: Titujt e Investimeve dhe Depozitat me Afat

Cështja Kryesore e Auditimit	Si u Trajtua Cështja gjatë Auditimit
Titujt e investimeve dhe depozitat me afat në banka përfaqësojnë së bashku një pjesë të konsiderueshme të totalit të aktiveve dhe kërkojnë nga AFSA për mbulimin e rezervave teknike të sigurimit. Risqet kryesore janë përshtatshmëria e klasifikimit sipas SNK 39, saktësia e matjes me kosto të amortizuar, vlerësimi i treguesve të zhvlerësimit dhe pajtueshmëria me kërkesat e AFSA për mbulimin e rezervave. E identifikua këtu si Cështje Kyçe Auditimi për shkak të madhësisë së gjendjeve dhe rëndësisë së tyre si aktive gjeneruese të të ardhurave dhe baze të kapitalit rregullator.	Procedurat tona të auditimit përfshijnë, ndërmjet të tjerave: - Vlerësimin e përshtatshmërisë së klasifikimit si hua dhe të arketueshme, duke konfirmuar mungesën e tregut aktiv sekondar dhe qëllimin e drejtimit për të mbajtur deri në maturim. - Kryerjen e rillogaritjeve të pavarura të kostos së amortizuar për një kampion titujsh duke përdorur metodën e normës efektive të interesit. - Vlerësimin e treguesve të zhvlerësimit për titujt e investimeve dhe depozitat bankare. Nuk u identifikua asnjë zhvlerësim. - Shqyrtimin e orarit të afatit të pagues dhe konfirmimin që aktivet e pranueshme plotësojnë kërkesat e mbulimit të rezervave teknike të AFSA dhe detyrimin minimal të fondit të garancisë. Konkluzion i auditorit: Bazuar në procedurat e kryera, titujt dhe depozitat janë klasifikuar saktë dhe matur me kosto të amortizuar sipas SNK 39. Kërkesat e AFSA për mbulimin e rezervave teknike u plotësuan. Nuk identifikua asnjë pasaktësi materiale.

Ekstrakt — Raporti i Audituesit të Pavarur, Grant Thornton Sh.p.k. (faqe 3/5)

Opiniononi i Shoqërisë Audituese

Çështje Kryesore të Auditimit

Informacione të tjera

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe publikimin e informacioneve të tjera. Informacione të tjera të marrë në datën e këtij raporti auditimi janë "Aneksë shoqëruese suplementare", por nuk përfshihen në pasqyrat financiare dhe raportin e auditimit.

Opiniononi ynë për pasqyrat financiare nuk përfshin informacione të tjera dhe ne nuk ofrojmë asnjë siguri mbi to. Si pjesë e auditimit, është përgjegjësi jonë të lexojmë këto informacione të tjera dhe të vlerësojmë nëse, bazuar në informacionet e marra gjatë auditimit tonë, ai përmban ndonjë mospërputhje materiale me pasqyrat financiare ose ndonjë gabim material të dukshëm. Nëse konkludojmë se ekziston një gabim material të fakteve në informacione të tjera, duhet ta raportojmë atë fakt. Sikurse është paraqitur në anekset suplementare Shoqëria ka logaritur marzhin mbi aftësinë paguese dhe aktivet në mbulim të rezervave teknike

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare individuale në përputhje me politikat kontabël të përkrahura në Shënimin 2 si edhe për sistemin e kontrollit të brendshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomal materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqesë në shënimet shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Shoqërisë, dhe të përdorë parimin e vijimësisë si bazë kontabile, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likudojë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomal materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomal materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë procesit së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare individuale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë, se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.

Ekstrakt — Raporti i Audituesit të Pavarur, Grant Thornton Sh.p.k. (faqe 4/5)

Opinion i Shoqërisë Audituese

Përgjegjësitë e Audituesit

- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen e shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtimi, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Në rast se ne arrijmë në konkluzionin që një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërpreje të aftësisë së Shoqërisë për vazhduar në vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare individuale, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare prezantojnë transaksionet dhe ngjarjet thelbësore në një mënyrë që arrin prezantimin e drejtë.

Ne komunikojmë me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen e shoqërisë, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brendshëm të cilat ne identifikojmë gjatë procesit të auditimit.

Raport mbi Përpunshmërinë me Kërkesat Ligjore dhe Rregullatore

Në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë për njësitë ekonomike me interes publik, deklarojmë se:

- Emërimi i audituesit:** Jemi emëruar si auditues ligjor nga Asambleja e Aksionarëve më datë 15/05/2025 dhe kemi shërbyer si auditues të Shoqërisë për një periudhë të pandërprerë prej 2 vitesh, duke përfshirë rinovimet përkatëse.
- Raport shtesë për Komitetin e Auditimit:** Opinioni ynë i auditimit mbi pasqyrat financiare është në përputhje me raportin shtesë të përgatitur për Komitetin e Auditimit, në përputhje me kërkesat e Rregullores nr. 44, datë 30.09.2025, të Bordit të Mbikqyrjes Publike.
- Shërbimet jo-audituese:** Gjatë periudhës së angazhimit nuk kemi ofruar shërbime të ndaluara jo-audituese dhe çdo shërbim tjetër i ofruar, nëse ka, është kryer në përputhje me kërkesat e legjislacionit dhe rregullores në fuqi.
- Pavarësia:** Ne kemi mbetur të pavarur gjatë gjithë periudhës së angazhimit, në përputhje me kërkesat etike, ligjore dhe rregullatore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Grant Thornton sh.p.k.

Tiranë, Shqipëri

31 mars 2026

Grant Thornton Sh.p.k.



Ergona Jash

www.grantthornton.al

vii

Ekstrakt — Raporti i Audituesit të Pavarur, Grant Thornton Sh.p.k. (faqe 5/5)

Pasqyrat Financiare

Sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar — 31 dhjetor 2025

Intersig Vienna Insurance Group Sh.A.
Pasqyra e Pozicionit Financiar

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

	Shënimi	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
AKTIVET			
Aktivitet afatgjatë materiale	8	213,554	224,842
Aktivitet afatgjatë jo-materiale	9	7,949	9,103
Aktive me të drejtë përdorimi	10	44,391	29,883
Aktive të mbajtura për investime	11	148,723	156,960
Investime në pjesëmarrje	12	24,601	24,601
Aktive të risigurimit	13	1,157,046	1,148,764
Letra me vlerë të mbajtura me koston e amortizuar	14	1,751,617	1,473,600
Depozita me afat në banka	15	1,253,147	1,115,164
Aktive të tjera	16	28,316	22,933
Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim	17	268,850	243,473
Llogari të arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera	18	23,181	51,586
Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre	19	106,739	199,387
TOTALI I AKTIVEVE		5,028,114	4,700,316
KAPITALI			
Kapitali aksionar	20	417,471	417,471
Rezerva ligjore e sigurimit	20	41,747	41,747
Fitim të mbartura		508,308	461,464
TOTALI I KAPITALIT		967,526	920,682
DETYRIMET			
Rezervat teknike të sigurimit	21	1,641,891	1,586,499
Rezerva për primet e paguara	22	1,149,153	1,045,010
Depozita e risiguresit	23	1,035,157	958,501
Detyrime për qira	10	43,165	30,513
Detyrime tatimore	24	29,263	27,266
Tatim fitimi i pagueshëm	36	6,943	3,247
Llogari të pagueshme nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera	25	155,016	128,599
TOTALI I DETYRIMEVE		4,060,588	3,779,634
TOTALI I KAPITALIT DHE DETYRIMEVE		5,028,114	4,700,316

Shënimet shoqëruese në faqet 5 deri 37 janë pjesë integrale e kësaj pasqyre financiare.

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga drejtimi i shoqërisë më datë 30 Mars 2026 dhe nënshkruar në emër të tyre nga:

Fitimete Sulaj
Intersig Vienna Insurance Group
INTERSIG
VIENNA INSURANCE GROUP
NIP: K132010027

Ilir Elmazi
VIG Services SH.A.

Intersig Vienna Insurance Group Sh.A.

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

	Shënimi	2025	2024
Prime të shkruara bruto	26	2,272,297	2,113,620
Ndryshimi në rezervën për primet e paguara	22	(104,143)	(107,955)
Të ardhura nga primi i sigurimit		2,168,154	2,005,665
Prime të ceduara të risiguresit	27	(933,273)	(901,426)
Ndryshimi në rezervën e risiguresit për primin e paguar	22	(4,006)	56,835
Prime të ceduara të risiguresit		(937,279)	(844,591)
Prime të fituara neto		1,230,875	1,161,074
Të ardhura nga komisionet e risigurimit	28	411,165	344,596
Të ardhura nga investimet	29	126,506	115,576
Të ardhura të tjera operative	30	13,741	6,080
Të ardhura neto		1,782,287	1,627,326
Dëme të paguara, bruto	21	(857,329)	(916,989)
Dëme të arkëtuara nga risiguresit	21	328,815	425,283
Ndryshimi në rezervën e dëmeve bruto	21	(55,392)	(111,351)
Ndryshimi në rezervën e dëmeve të risiguresit	21	12,286	91,619
Dëme dhe përfitime të sigurimit, neto		(571,618)	(511,438)
Shpenzimet e marrjes në sigurim	31	(532,417)	(500,722)
Shpenzime administrative	32	(370,918)	(331,476)
Shpenzime të tjera nga aktiviteti i sigurimit	33	(44,094)	(40,792)
Shpenzimet		(947,429)	(872,990)
Shpenzime financiare	34	(30,128)	(29,542)
Humbje nga kurset e këmbimit, neto	35	(13,031)	(21,887)
Shpenzime të tjera		220,082	191,469
Fitimi para tatimit		(36,199)	(30,244)
Tatimi mbi fitimin	36		
Fitimi i vitit		183,883	161,225
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		-	-
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin		183,883	161,225

Shënimet shoqëruese në faqet 5 deri 37 janë pjesë integrale e kësaj pasqyre financiare.

Ekstrakt nga Pasqyrat Financiare të audituara (faqe 1/2)

Pasqyrat Financiare

Skedulet Supplementare — 31 dhjetor 2025

Intersig Vienna Insurance Group sh.a.
Pasqyra e Flukseve monetare – 31 dhjetor 2025
(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

	Shënimi	2025	2024
Fitimi para tatimit		220,082	191,469
Flukset monetare nga aktivitetet operative			
<i>Rregullime për:</i>			
Zhvlerësimin dhe amortizimin	32	47,415	46,457
Humbje nga zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimit	32	1,437	-
Humbje nga shitje e aktiveve afatgjata materiale			
Shpenzime interesi		25,555	24,496
Të ardhura nga investimet		(126,506)	(115,576)
Efekt nga kurs i këmbimit			
Flukset monetare nga aktiviteti operativ para ndryshimeve në aktive dhe detyrime		167,983	146,846
Ndryshime në aktive të sigurimit		(8,282)	(148,454)
Ndryshime në aktive të tjera		(5,352)	(932)
Ndryshime në shpenzimet e shëtyra të manjes në sigurim		(25,377)	(19,958)
Ndryshime në llogari të arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera		28,405	28,405
Ndryshime në rezervat teknike të sigurimit		55,392	111,351
Ndryshime në rezervën e primeve të paguara		104,143	107,955
Ndryshime në depozitën e risiguruesit		76,656	97,049
Ndryshime në detyrimet tatimore		1,997	(303)
Ndryshime në llogari të pagueshme nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera		26,418	26,418
Flukset monetare të gjeneruara nga aktiviteti operativ		253,970	166,319
Interesi i arkëtuar		99,262	80,115
Tatimi mbi fitimin i paguar		(32,503)	(32,050)
Flukset monetare neto nga aktivitetet operative		488,712	361,230
Flukset monetare nga aktivitetet investuese			
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	8	(10,448)	(3,474)
Blerje e aktiveve afatgjata jo-materiale	9	(2,088)	(1,000)
Blerje e letrave me vlerë të investimeve me kosto të amortizuar	14	(279,374)	(182,859)
Maturimi i investimeve me kosto të amortizuar	14	13,537	100,000
Ndryshime në depozitat me afat në banka		(146,530)	(113,011)
Ujje në investimet në pjesëmarrje		-	-
Flukset monetare neto të përdorura në aktivitetet investuese		(424,903)	(200,344)
Flukset monetare nga aktivitetet finacuese			
Pagesat e qirave	10	(17,238)	(14,203)
Dividendi i paguar	20	(137,039)	(113,045)
Flukset monetare neto të përdorura në aktivitetet finacuese		(154,277)	(127,248)
Translation effect		(2,180)	2,856
Rritja neto në mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre		(92,648)	36,494
Mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre në fillim të vitit		199,387	162,892
Mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre në fund të vitit		106,739	199,387

Ekstrakt nga Pasqyrat Financiare të audituara (faqe 2/2)

Objektivat 2026

Primet e Shkruara të planifikuara sipas produktit

Produkti	Vlera (në mijë lekë)
TPL	1,480,000
Kartoni Jeshil	245,000
Kufitare	52,000
Kasko	155,000
Aksidente Personale	17,000
Sigurim Prone	160,000
Sigurim Përgjegjësie	50,000
Sigurim Garancie	40,000
Mall në Transport	5,000
Shëndet në Udhëtim	7,000
Sigurim Shëndeti	130,000
Përgjegjësi Avion	10,000
Kasko Avion	10,000
Përgjegjësi Anije	4,000
Kasko Anije	5,000
Grand Total	2,370,000

Make Life Easy!

Kontakt

Dega Qendrore

Adresa: Rruga "Ismail Qemali", Samos Tower, Kati i 2-të, Ish-Bllok,
Tiranë

Tel: +355 (0) 4 22 70 576

E-mail: info@intersig.al

Website: www.intersig.al

Publikuar më 30.06.2026